

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E ENJTE 3 SHKURT 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot në fjalën time dua të ndalem në një çështje me një rëndësi të veçantë, siç është dhuna apo ngacmimi në vendin e punës. Të gjithë jemi koshientë që dhuna në vendin e punës është diçka që ndodh rëndomtë, edhe në hapësira të ndryshme, si në publik, ashtu dhe në privat. Pa diskutim që përdorimi i çdo lloj forme të dhunës në punë sjell abuzim me pushtetin, por, njëkohësisht, nënkupton edhe shkeljen e një sërë të drejtave të Kodit të Punës dhe të drejtave të njeriut. Në kuadër të përmirësimit dhe zgjidhjes së këtij problemi vjen dhe projektligji për ratifikimin e konventës 190 “Për dhunën dhe ngacmimin” nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Po të ndalemi më poshtë, objektivat që synohen të arrihen me ratifikimin e kësaj konvente janë: forcimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues; krijimi i hapësirave në zbatimin e parimeve të kësaj konvente, duke përmirësuar legjislacionin kombëtar, përafrimin me standardet ndërkombëtare të punës së ILO-s, atë të Bashkimit Europian dhe vendeve të tjera të zhvilluara në botë në këtë fushë; nxitja e ndërveprimit të organizatave të punëdhënësve e punëmarrësve dhe strukturave përgjegjëse shtetërore në luftën kundër këtij fenomeni; gjithashtu, institucionet/autoritetet do të përmbushin siç duhet detyrimet e tyre për të mbrojtur viktimën, përfshirë kategoritë vulnerabël, për një mjedis pune të shëndetshëm e miqësor; rritja e ndërgjegjësimit, formimit profesional dhe mbrojtja efektive e viktimave të prekura nga dhuna dhe ngacmimet në botën e punës, duke ndikuar në sigurinë, në shëndetin dhe efektivitetin në punë. Nisur nga objektivat e lartpërmendura dhe synimet tona për të aderuar në Bashkimin Europian, një element për t’u bërë pjesë e kësaj organizate është edhe arritja e standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Po ashtu, edhe në Kodin e Punës është përcaktuar fort mirë: “Punëdhënësi ndalohet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim apo ngacmim seksual për punëmarrësin dhe nuk lejon kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrësit. Është e ndaluar nga punëdhënësi çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime, si veprime fizike e simbolike, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal të tij”. Po citoj përsëri Kodin e Punës: “Punëdhënësi ndalohet të ngacmojë punëmarrësin me veprimeve, të cilat kanë për qëllim ose sjellin si pasojë degradimin e kushteve të punës në një shkallë të tillë, që mund të çojë në cenimin e të drejtave dhe dinjitetit të personit, në dëmtim të shëndetit të tij fizik ose mendor, në dëmtim të së ardhmes të tij profesionale”. Mbetet detyrë e shtetit dhe e instancave të tij, që duhet të jenë të vëmendshme ndaj formave të ndryshme të dhunë në vendin e punës.

Po ashtu, edhe detyra e punonjësve socialë dhe veçanërisht e psikologut, duhet të jetë edhe më e vlerësuar dhe e fuqizuar për të evidentuar raste të tilla. Këto situata në vendin e punës, në shumicën e rasteve as nuk referohen, pasi nuk dinë kujt t’i referohen apo kujt t’i drejtohen. Nisur nga sa më lart, mund të flasim për legjislacionin dhe problematikën në tërësi, por nuk kemi një përqindje reale për sa

i përket përdorimit të dhunës në vendin e punës. Kur diskutojmë për dhunën në vendin e punës, gjëja e parë që mendojmë është një sulm fizik, por, në fakt, dhuna në vendin e punës është një shqetësim shumë i madh dhe më i gjerë. Natyrisht, largohet dëshira për të punuar apo për të shkuar në punë, duke krijuar minimumi një gjendje paretie deri te rreziku real për jetën. Kjo konventë është për herë të parë dhe artikulon kaq qartë të drejtën e secilit për një mjedis pune të lirë nga dhuna dhe nga ngacmimet, duke identifikuar edhe sjelljet që mund të përbëjnë shkelje ose abuzim të të drejtave të njeriut. Po ashtu, konventa ofron mbrojtje të të gjithë personave që punojnë, pavarësisht statusit të marrëdhënieve të punës, përfshirë edhe praktikantët, vullnetarët, aplikantët, si dhe punëdhënësit. Ajo zbatohet si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, si në zonat urbane, ashtu dhe në ato rurale. Kjo çështje është tejet sensitive dhe përfshin të gjithë punonjësit, por edhe punëdhënësit, pasi nga të dyja palët mund të manifestohen sjellje të dhunshme si verbale, psikologjike apo fizike. Disa grupe punonjësish në sektorë të caktuar pranohet të jenë veçanërisht më të prekshmit ndaj dhunës e ngacmimeve, kryesisht në shëndetësi, në transport, në arsim, në punët shtëpiake, në punët e natës, pra me turne, dhe në punët në zonat e izoluar.

Fokusi në këta sektorë, që janë më të predispozuar për të pasur dhunë apo ngacmime të ndryshme në punë, duhet të jetë akoma më i madh dhe në kujdesin e të gjithë aktorëve të përfshirë. Me ratifikimin e kësaj konvente, shtetet që do ta përqafojnë kanë hapësira në zbatimin e parimeve të saj nga strukturat përkatëse, të cilat monitorojnë, inspektojnë në përmbushjen e detyrimeve, në reduktimin e eliminimit të dhunës e të ngacmimit në punë dhe sigurojnë ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e duhur të viktimave dhe të organizatave respektive të punëdhënësve e punëmarrësve dhe strukturave të politikëbërjes në këtë drejtim. Gjithashtu, për sa i përket përgjegjësisë institucionale, ratifikimi i kësaj konvente mund të sjellë rezultate pozitive, të cilat mund të krahasohen më atë të konventave të mëdha, si të Konventës së Këshillit të Europës, e njohur si konventa e Stambollit. Mjedisi i punës ka një ngjashmëri të madhe me mjedisin familjar. Për këtë arsye, i duhet kushtuar e njëjta vëmendje. Jo vetëm duhet të jemi të sigurt në mjedisin e punës dhe të mos cenohet asnjë e drejtë legjitime e punonjësit, por edhe vetë vendi i punës duhet të jetë një mjedis sa më pozitiv, pse jo, edhe frymëzues. Një punë e bërë me dëshirë, ku punohet me një mjedis sa më larg çdo lloj forme të dhunës, është një punë shumë më produktive. Në fakt, në punë çfarë mbjell, do të korrësh. Në fund të fjalës sime, dua t'u bëj një thirrje institucioneve përgjegjëse, që këtë gjë ta shohin me prioritet dhe të mos e shohin si një gjë të dorës së dytë.

Në fakt, doja të propozoja edhe për ministren e Shëndetësisë, do të ishte mirë edhe për ministren e Financave, që në institucione si Inspektorati i Punës të ketë një shtim të stafit, sepse ka shumë raste që mund të monitorohen, ka shumë raste që mund të jenë bërë shkak i ngacmimeve apo dhunës në punë, por asnjë nuk është adresuar, sepse, siç e thashë më lart, shumë prej njerëzve, të cilët mund të kenë pasur probleme qoftë në sektorin publik, qoftë në sektorin privat, nuk kanë ditur ku të adresohen dhe, duke mos ngjallur siguri, ata kanë frikë, sepse duke mos e marrë seriozisht apo duke mos pasur vëmendjen e duhur, nuk e delegojnë rastin. Pra, në fakt, vendi i punës realisht duhet të jetë si një vend familjar, ku çdo njeri të punojë me qejf. Do të kërkoja që Inspektorati i Punës të kishte një shtesë ose të kishte një grup, që të mund t'i monitoronte sidomos profesionet më të rrezikuara, duke pasur në përbërje sidomos psikologë, juristë apo punonjës socialë, për t'i deleguar këto probleme, normalisht, duke pasur një trinom, një lidhje ndërmjet institucioneve: Inspektorati i Punës-polici-Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Faleminderit!